



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

ceruz 15 45 7

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI - SKUPŠTINA - REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO

Zyra për Programim dhe Parashitje - Kancelarija e Prodhimit dhe Përditësimit të Dokumenteve
No. 06/1944/Do-1067
Data: 18.09.2018
Prishtinë - PRISTINA - PRISTINA

Për: Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Cc: Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Nga: Grupi Parlamentar i LDK-së *[Signature]*

Data: 18.09.2018

Lënda: Kërkesë për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës

I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Grupi Parlamentar i LDK-së, Grupi Parlamentar të LVV-së, Grupi Parlamentar i PSD-së dhe deputetët e pavarur Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda, në bazë të nenit 69, paragrafi 4, të Kushtetutës të Republikës të Kosovës, dhe të nenit 38 të Rregullores të Kuvendit, kërkojnë mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës më 20.09.2018, në orën 14:00, me këtë rend dite:

1. *Votimi i Projektligjit nr. 06/L-90 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian*
2. *Votimi i Projektligjit nr. 06/L-94 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët".*
3. *Votimi i Projektligjit nr. 06/L-95 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +" Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.*

Arsyetim i kërkesës për seancë të jashtëzakonshme:

Duke pas parasysh se asistencat e BE-së në procesin e integrimit evropian të Republikës së Kosovës, e posaçërisht asistencat në përmbushjen e obligimeve të dala nga MSA-ja, siç janë asistencat që rrjedhin nga ratifikimi i këtyre tri marrëveshjeve të cekura më lartë, kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, përkatësisht tek të rinjtë të cilët janë përfitues direkt nga programi "Erasmus +", vlerësojmë se ratifikimi i tyre duhet të ndodh sa më parë.

Vlerësojmë se është e nevojshme që sa më parë të ndodh ratifikimi i këtyre marrëveshjeve në mënyrë që projektet të cilat varen nga këto marrëveshje, që burojnë nga marrëveshja e MSA-së, të fillojnë të zbatohen dhe të finalizohen me kohë.

Specifikat e këtyre marrëveshjeve dhe rëndësia e tyre është përshkruar në vijim:

1. Marrëveshja Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian:

Marrëveshja e IPA-së, pjesa e parë, ka një kosto totale të programit prej 49,473,378 euro, prej të cilave kontributi maksimal i BE-së është 48 milion euro, shumë kjo e cila do të alokohet para datës 31.12.2018. Andaj, ratifikimi i kësaj marrëveshje duhet të ndodh sa më parë.

2. Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët".

Marrëveshja për pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët" i mundëson Kosovës qasje në 17 programe të BE-së, të cilat lehtësojnë rrugëtimin e Kosovës drejt integrim evropian.

3. Marrëveshja ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +" Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.

Marrëveshja për pjesëmarrjen e Kosovës në "Erasmus +" parasheh platformën mbështetëse të IT, përfshirë e-Binjakëzimin, si dhe mbështetjen për reformën e politikave në arsim dhe politikave për rini.

Bazuar në ato që u thanë më lartë si dhe në faktin se diskutimi për këto marrëveshje ka përfunduar seancat e kaluara të Kuvendit, kërkojmë që Kuvendi i Kosovës të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme në datën e cekur më lartë në fillim të kësaj kërkese dhe të votoj ratifikimin e këtyre marrëveshjeve, i cili votim ishte paraparë edhe në seancën e thirrur të datës 13.09.2018.

Nënshkrimet e deputetëve i janë bashkangjitur kësaj kërkese:

Me respekt,

Avdullah Hoti

Kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës

